

KONTRATË SHITBLERJE KUOTE KAPITALI

Sot më datë 08.07.2025 (dymijë e njëzet e pesë), palët kontraktuese të poshtëshënuara, hartojnë këtë kontratë shitblerje kuote kapitali në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "LUBEG" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I. PALËT

Pala Shitëse:

z. Skënder Pashaj, shtetas shqiptar, lindur me 23.02.1970, në Durrës dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit bashkëlidhur kësaj kontrate.

Pala Blerëse:

1) Shoqëria "BEJD GROUP" SHPK, shoqëri tregtare e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS (NIPT) L81829009J, me zyrë qendrore në adresën rruga "Marko Boçari", Ndërtesa Nr. 6, Hyrja 1, Dyqani Nr. 3, Kati përdhe, Tiranë, e përfaqësuar administratori z. Ermir Hyra, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit bashkëlidhur kësaj kontrate.

2) Shoqëria "H2O TEAM" SHPK, shoqëri tregtare e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS (NIPT) L92413024J, me zyrë qendrore në adresën Kompleksi Gintash, godinat e biznesit nr. 2, kati i dytë, Tiranë, e përfaqësuar administratorja znj. Elvana Rajta, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit bashkëlidhur kësaj kontrate.

3) Shoqëria "LM & RO" SHPK, shoqëri tregtare e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS (NIPT) M12109041J, me zyrë qendrore në adresën Mjull Bathore, rruga "Varrosh - Mjull", Varrosh; Nd.15; H.1; Farkë, Tiranë, e përfaqësuar administratorja znj. Migena Dushku, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit bashkëlidhur kësaj kontrate.

4) z. Gentian Daja, shtetas shqiptar, lindur më 19.07.1976, në Kavajë dhe banues në Qerret, Kavajë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit bashkëlidhur kësaj kontrate.

Kushtet Paraprake

1) Shoqëria "LUBEG" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 11.10.2021, e pajisur me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) M12211009M; me zyrë qendrore në Tiranë, rruga "Marko Boçari", Ndërtesa nr. 6, Hyrja nr. 1, Dyqani nr. 3, Kati Përdhe, me kapital të regjistruar ALL 1,000,000 (një milion lekë); me 5 ortakë: shoqërinë "BEJD GROUP" SHPK, zotëruese e 1 (një) kuote e cila përbën 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë; z. Gentian Daja, zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;



shoqërinë "H2O TEAM" SHPK, zotëruese e 1 (një) kuote e cila përbën 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë; shoqërinë "LM & RO" SHPK, zotëruese e 1 (një) kuote e cila përbën 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe z. Skënder Pashaj, zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë

2) Pala shitëse është e interesuar të shesë kuotën e cila përfaqëson 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "LUBEG" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë kuotë;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Skënder Pashaj, i shet palës blerëse shoqërisë "BEJD GROUP" SHPK 5% të kuotës që ai zotëron në shoqërinë "LUBEG" SHPK.

2.2 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Skënder Pashaj, i shet palës blerëse shoqërisë "H2O TEAM" SHPK 5% të kuotës që ai zotëron në shoqërinë "LUBEG" SHPK.

2.3 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Skënder Pashaj, i shet palës blerëse shoqërisë "LM & RO" SHPK 5% të kuotës që ai zotëron në shoqërinë "LUBEG" SHPK.

2.4 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Skënder Pashaj, i shet palës blerëse Gentian Pashaj 5% të kuotës që ai zotëron në shoqërinë "LUBEG" SHPK.

2.5 Pas regjistrimit të kësaj kontrate dhe pasqyrimit të ndryshimeve në fletën e regjistrimit të shoqërisë, përbërja e ortakërisë së shoqërisë "LUBEG" SHPK, do të jetë si më poshtë vijon:

- shoqëria "BEJD GROUP" SHPK, do të jetë zotëruese e 1 (një) kuote e cila përfaqëson 25% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- shoqëria "H2O TEAM" SHPK, do të jetë zotëruese e 1 (një) kuote e cila përfaqëson 25% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- shoqëria "LM & RO" SHPK, do të jetë zotëruese e 1 (një) kuote e cila përfaqëson 25% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Z. Gentian Daja, do të jetë zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 25% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës që z. Skënder Pashaj zotëron në shoqërinë "LUBEG" SHPK, objekt i kësaj kontrate, është në total ALL 200,000 (dyqind mijë lekë).

3.2 Çmimi i kësaj kontrate do të paguhet nga blerësit si më poshtë vijon:

- shoqëria "BEJD GROUP" SHPK do të paguajë një çmim prej ALL 50,000 (pesëdhjetë mijë lekë) për pjesën e kuotës që blen;
- shoqëria "H2O TEAM" SHPK do të paguajë një çmim prej ALL 50,000 (pesëdhjetë mijë lekë) për pjesën e kuotës që blen;
- shoqëria "LM & RO" SHPK do të paguajë një çmim prej ALL 50,000 (pesëdhjetë mijë lekë) për pjesën e kuotës që blen.
- Z. Gentian Daja do të paguajë një çmim prej ALL 50,000 (pesëdhjetë mijë lekë) për pjesën e kuotës që blen.

3.3 Palët në kontratë deklarojnë se duke qenë se kanë kohë që diskutohet midis tyre blerja e kuotës së ortakut Skënder Pashaj, çmimi i kësaj kontrate është likuiduar tërësisht nga palët blerëse në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.



IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala deklarojnë se nëpërmjet transferimit të kuotës nga shitësi tek blerësi, transferohen dhe të gjithë të drejtat dhe detyrimet që mbart kjo kuotë.

4.2 Palët kësaj kontrate detyrohen që asnjëra prej tyre të mos tërhiqet nga kjo kontratë. Në rast se ndonjëra prej palëve tërhiqet nga kontrata apo kryen ndonjë veprim me qëllim mosplotësimin e kushteve të përcaktuara në dispozitat e kësaj kontrate, atëherë pala që tërhiqet ose kryen veprimin, detyrohet t'i paguajë palës tjetër një penaltitet sipas ligjit.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Në referim të dispozitave të Kodit Civil dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate pronësia kalon nga pala shitëse tek pala blerëse.

5.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pasqyrohet në fletët e regjistrimit të shoqërisë, duke u bërë publike për të tretët fakti, se pronësia mbi kuotën e cila përbën 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "LUBEG" SHPK, do të kalojë nga pala shitëse Skënder Pashaj, tek pala blerëse.

5.3 Nga momenti e nënshkrimit të kësaj kontrate pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e cila përfaqëson 20% të kapitalit të shoqërinë "LUBEG" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse.

Kjo kontratë hartohet në 6 (gjashtë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kontrata pasi u lexua me zë të lartë prej palëve, deklarohet prej tyre se që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë dhe nënshkruhet rregullisht e në mirëbesim, në bazë të ligjit.


PALA SHITËSE

SKËNDER PASHAJ

Skender Pashaj


PALA BLERËSE

Shoqëria "BEJD GROUP" SHPK
përfaqësuar nga administratori
ERMIR HYRA

Ermit HYRA


Shoqëria "H2O TEAM" SHPK
përfaqësuar nga administratori
ELVANA RAJTA

ELVANA RAJTA


Shoqëria "LM & RO" SHPK
përfaqësuar nga administratori
MIGENA DUSHKU

Migena Dushku
GENTIAN DAJA
GENTIAN DAJA
